



KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Prishtinë / Prishtine	28.06	1	1/8
Emri i Aktit / Name of Act	3324/2021		
Emri i Autorit / Name of Authority			
Emri i Komisionit / Name of Commission			
Emri i Komisionit / Name of Commission			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.456/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.246/2020 e datës 26.05.2021 të Gjykatës Themelore-Departamentit për Çështje Administrative në Prishtinë, ka shqyrtuar ankesën e datës 30.12.2019 me numër A.nr.781/2019, të parashtruar nga ankuesi me adresë, rruga "Eduard Lir", nr.16 në Komunë të Prishtinës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punë-masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.781/2019 e datës 30.12.2019 e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET** Vendimi me numër Nr.391-KA-2019 i protokolluar me datës 27.12.2019 i Komisionit për Ankesa në Policinë e Kosovës, **Anulohet** Vendimi Nr.1923-2019 i datës 03.12.2019 i Komisionit të Brendshëm Disiplinor në Policinë e Kosovës.
- II. OBLIGOHET** Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, të ndermerr veprimet administrative që brenda afatit prej 15 ditësh të bëjë zbatimin e këtij vendimi, nga dita e pranimit të tij, lidhur me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënien e punës, për ankuesin.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Policinë e Kosovës, në pozitë "Inxhinier i elektros", në Drejtorinë për Menaxhimin e Objekteve sipas Akt emërimit të datës 03.04.2012, i cili është caktuar menaxher i kontratës me nr.214/15/034/211, e lidhur në mes të Policisë së Kosovës me datës 27.07.2015 dhe kompanisë "NTP Flomed" për Shërbimet e Dezinfekimit, Dezinfektimit, Dearatizimit(DDD) dhe Kontrollit të Shpendëve dhe Zvarranikëve në Policinë e Kosovës. Ndaj të cilit është inicuar kallëzim penal nga Inspektorati Policor i Kosovës me datë 28.01.2018, për shkak të dyshimit se ka kryer veper penale "keqperdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar e sanksionuar sipas nenit 422 par.1 të KPRK-së".

Me datë 26.12.2018 Prokuroria Themelore -Departamenti të Krimeve të Rënda në Prishtinë ka nxjerrë Aktvendimin me numër PP.Lnr.3/18, me të cilin i ka pushuar hetimet ndaj ankuesit për shkak se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm që është kryer veper penale "keqperdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar e sanksionuar sipas nenit 422 par.1 të KPRK-së".

Me datë 28.05.2018 Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës, ka proceduar në Komision të Brendshëm Disiplinor, lëndën me numër 092-PK-2018 IPK-DH-02-18-VP, për ankuesin #1580, duke rekomanduar që ndaj tij të shqiptohet masë disiplinore e rëndë "Ndërprerje e marrëdhënies së punës" e cila lëndë është pezulluar nga Komisioni i Brendshëm Disiplinor me Vendimin e datës 14.06.2018, për shkak të krijimit të rrethanave të reja sepse ndaj ankuesit ishte ushtruar kallëzim penal nga Inspektorati Policor i Kosovës me nr. IPK/DH/02/18/VP, duke e shtyrë përkohësisht procedurën e shqyrtimit disiplinor.

Policia e Kosovës, pasi që me datë 15.11.2019 ka pranuar Aktvendimin me numër PP.Lnr.3/18 të datës 26.12.2018 nga Prokuroria Themelore -Departamenti të Krimeve të Rënda, është njoftuar dhe Komisioni i Brendshëm Disiplinor i cili me datë 27.11.2019 ka nxjerrë Vendimin me numër 1098/KBD/'19, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masë disiplinore "Ndales në pagë 30% për 3 muaj nga paga bruto", pasi ka pranuar Aktvendimin me numër PP.Lnr.3/18 të Prokurorisë Themelore -Departamenti të Krimeve të Rënda në Prishtinë të datës 26.12.2018.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër 1098/KBD/'19, të datës 27.11.2019, të Komisionit të Brendshëm Disiplinor të Policisë së Kosovës, ka parashtruar ankesë me datës 17.12.2019 tek Komisioni i Ankesave në Policinë e Kosovës i cili me datës 27.12.2019 ka nxjerrë Vendimin me numër nr.391-KA-2019, i cili ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar dule lënë fuqi Vendimin me numër 1098/KBD/'19, të datës 27.11.2019.

I pakënaqur me Vendimin e Komisionit të Ankesave të Policisë së Kosovës me datës 30.12.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore për anulimin masës disiplinore dhe kundër Vendimit të Komisionit të Ankesave, sepse janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.01.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Më datë 27.01.2020 organi i punësimit ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 20.01.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke inicuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 21.05.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.246/2020, të pranuar me datë 28.05.2021, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos lidhur me ankesën e ankuesit të datës 30.12.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Aktgjykim i datës 26.05.2021 me numër A.nr.246/2020 i Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë; Ankesa e ankuesit me shkresat e bashkangjitura, ankesa A.nr.781/2019 e datës 30.12.2019 me numër protokoll 5959/2019; Vendimi me numër nr.391-KA-2019 i protokolluar me datës 27.12.2019 i Komisionit për Ankesa në Policinë e Kosovës; Vendimi me numër 1098/KBD/19 i datës 27.11.2019 i Komisionit të Brendshëm Disiplinor në Policinë e Kosovës; Aktvendimin me numër PP.I.nr.3/18 të Prokurorisë Themelore -Departamenti të Krimeve të Rënda në Prishtinë me datë 26.12.2018,(me numer protokoll 02-116/1919-5 i datës 04.11.2019); Përgjigje në ankesë e datës 28.01.2020; Aktemerimi i datës 03.04.2012;Vendimi me numër protokoll 1923/2019 i datës 03.12.2019 i Komisionit të Brendshëm Disiplinor në Policinë e Kosovës; Email zyrtar i datës 24.01.2020, i datës 23.01.2020; Vendimi me numër protokoll ZDP0102/01/1836/18 i datës 14.06.2018 i Komisionit të Brendshëm Disiplinor në Policinë e Kosovës;Lënda disiplinore Nr.092-PK-2018; Raport përfundimtar i hetimeve me rekomandim i datës 15.05.2018, lidhur me lëndën disiplinore për punonjësin e Policisë së Kosoves SC#1580; Raporti Nr.092-PK-2018 IPK/DH/18/VP i përgjithshëm i hetimeve i datës 07.05.2018, nga Zyra DPP-së; Njoftim i datës 26.01.2018 lidhur me rastin IPK/DH/02/18/VP për Drejtorinë për Standarde Profesionale në Policinë e Kosovës , për ankuesin; Kallëzimi penal i datës 15.01.2018 nr. Rastit IPK/DH/02/18/VP; Njoftim zyrtar-shtesë për fillimin e hetimeve të brendshmei datë 04.05.2018 për ankuesin; Njoftim zyrtar-shtesë për fillimin e hetimeve të brendshmei datë 08.03.2018 për ankuesin; Ftesë e datës 16.03.2018; Ftesë e datës 27.03.2018; Ftesë e datës 30.04.2018; Ftesë e datës 03.05.2018; Procesveral i datës 19.03.2018, i datës 02.05.2018; Pranim-dorëzimi i datës 26.02.2018; Njoftim zyrtar-shtesë për fillimin e hetimeve të brendshmei datë 18.01.2018 për ankuesin; Kërkesë e datës 27.07.2016 për fillimin e hetimor referenc DDSHM-08-207-2016; E-mail i datës 08.10.2015; E-mail i datës 18.01.2016 dhe i datës 25.01.2016; Prapsim me numër P.nr.415/2016 nga Përmbauesi Privat; Raporti për shërbime e datës 13.06.2016, me listën e Menaxhimit të kontratave; Raport Policor i marrjes në pyetje të dyshuarit i datës 25.07.2017; Fletedergesë e datës 17.08.2016; Njoftim i datës 15.06.2016 per moszbatimin e detyrave dhe përgjegjesive të projektmenaxherit; Kontartë Nr-214/15/034/211, për shërbimet e DDD



dhe kontrollit i shpendëve dhe zvarranikëve në Policinë e Kosovës dhe "Flomed"; Sigurimi i ekzekutimit të tenderit i datës 28.07.2015 me listë emimeve; Urdhër i datës 06.06.2016 nga Përmbartuesi privat nr. 662/2016; Dosja e tenderit "Flomed", Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 20.05.2016 SP Malishevë, Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 20.05.2016 SP Rahovec; Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 19.05.2016 SP Gracanicë, Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 20.05.2016 SP Janjevë, Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 19.05.2016 SP Mamushë, Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 17.05.2016 SP Lipjan, Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 17.05.2016 SP Shtime, Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 17.05.2016 SP Shtërpce, Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 17.05.2016 SP Ferizaj, Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 20.05.2016 SP Hani Elezit, Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 17.05.2016 SP Kacanik, Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 18.05.2016 SP Gllloboqic; E-mail i datë 07.06.2016, i datës 09.06.2016, i datës 10.06.2016, i datës 14.06.2016, i datës 13.06.2016; E-mail i datë 06.06.2016, E-mail i datë 07.06.2016, E-mail i datë 03.05.2016, E-mail i datë 27.05.2016, E-mail i datë 23.05.2016, E-mail i datë 12.05.2016, E-mail i datë 06.05.2016, E-mail i datë 20.04.2016, E-mail i datë 19.04.2016, E-mail i datë 18.01.2016, E-mail i datë 14.01.2016, E-mail i datë 21.01.2016; Kërkesë e datës 27.05.2016 për blerjen e produkteve, shërbim dhe punë, Raport për shërbim i datës 20.05.2016 nr. Ref.DMO/16; E-mail i datë 23.05.2016; Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 10.05.2016 Njësia KS Lebane; Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 10.05.2016, Kampi në Mitrovicë, Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 12.05.2016 DRVP Lluzhan, Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 12.05.2016 SP Kërrpimeh, Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 12.05.2016 PKK Merdare, Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 13.05.2016 Objekti Uniforma në Prishtinë, Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 13.05.2016 Log Baza në Prishtinë, Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 13.05.2016 Depo DMO-së në Prishtinë, Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 13.05.2016 flota operatiive në Prishtinë, Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 13.05.2016 Dy tendat në Prishtinë; Email i datës 12.05.2016; Email i datës 06.05.2016; Email i datës 20.04.2016 dhe 19.04.2016; Raport i analizës përfituese e datës 23.05.2016 prej 1/3 faqe; Email i datës 23.04.2016 dhe 24.04.2016; Kërkesë për pagesë e datës 30.06.2016; Ankesë kundër prapsimit i datës 30.06.2016; Fatura nr.72-2016-FD -Dosja e tenderit të datës 19.05.2016 ; Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 20.05.2016 SP Suharek; Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 20.05.2016 NSP Mushtisht; Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 23.05.2016 Pika statistikore Zym; Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 23.05.2016 NSP Zhur; Vendimi i kryerjes së shërbimeve DDD në Policinë e Kosovës 23.05.2016 SPMK Vërmicë; E-mail i datës 06.04.2018 dhe 04.04.2018 kërkesë për sigurimin e deshmive; E-mail i datës 26.04.2018; E-mail i datës 06.11.2017; E-mail i datës 05.04.2016; E-mail i datës 05.08.2016; E-mail i datës 29.07.2016; E-mail i datës 18.04.2018; E-mail i datës 17.04.2018; E-mail i datës 04.04.2018; Urdhër Pagesë, e shpenzimeve e datës 18.12.2015; Urdhër Pagesë, e shpenzimeve e datës 09.12.2015, ½ faqe; Urdhër Pagesë, e shpenzimeve e datës 17.07.2015; Urdhër obligimi i Pagesës, i datës



datës 17.07.2015; Urdhër obligimi i Pagesës, i datës 02.06.2016; Kërkesë për blerjen e produkteve, shërbim dhe punë i datës 15.06.2016; Urdhër Pageese, e shpenzimeve e datës 29.06.2016 prej 1/3 faqe; Shënim zyrtar nga Drejtori a e stabndardeve profesionale NJSP-zyra në DPP; Dërgim i propozimit për përmbarrim NTP Flormed i datës 15.06.2016 për Ministrinë e drejtësisë-Avokatit Shtetror; E-mail i datës 17.06.2016 propozim për përmbarrim; E-mail i datës 16.06.2016 kërkesë për këshillë; E-mail i datës 07.04.2018 kontrat korniz; Kërkesë për blerjen e produkteve, shërbim dhe punë i datës 18.03.2015; E-mail i datës 07.05.2018 Plani DDD për vitin 2016 faza e I dhe II; E-mail i datës 07.05.2018 kërkesë për interpretim; E-mail i datës 02.02.2016; E-mail i datës 07.05.2018, Përgjigje lidhur me deshmi nga Thesari në kuadër të Ministrisë së Financave; Urdhër nr. Protokolli 2357 Transfer -Thesari, i datës 01.11.2017; Raporti i datës 07.05.2018.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit *është e bazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, fillimisht ka kontaktuar se ankuesi është i punësuar në Policinë e Kosovës në vendin e punës "Inxhinier i elektros", në Drejtorinë për Menaxhimin e Objekteve me Akt emërimin e datës 03.04.2012, duke u bazuar në themelimin e marrëdhënies së punës ankuesi është staf civil në Policinë e Kosovës, sipas Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të nenit 3 paragrafin 5 të Ligjit Nr.3/L-149 për Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ankuesi është nëpunës civil i punësuar në Policinë e Kosovës, siç e përcakton: "5. *Personeli civil i punësuar në Policinë e Kosovës, në Forcën e Sigurisë së Kosovës, në Doganat e Kosovës, në Shërbimin Korrektues të Kosovës, është pjesë e shërbimit civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi*", mbi këtë bazë është konstatuar se ankuesi është nëpunës civil i punësuar në Policinë e Kosovës, i cili është caktuar menaxher i kontratës e lidhur me datë 28.07.2015 me nr.214/15/034/211, në mes të Policisë së Kosovës dhe kompanisë "NTP Flormed", për Shërbimet e Dezinfekimit, Dezinsektimin, Dearatizimin(DDD) dhe Kontrollit të Shpendëve dhe Zvarranikëve në Policinë e Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka analizuar pretendimet e ankuesit i cili kundërshton Vendimin e datës 27.12.2019 të Komisionit të Ankesave të Policisë së Kosovës, i cili i ka refuzuar ankesën në kundërshtim me ligjin në fuqi, nuk ka vërtetuar gjendjen faktike dhe bazën juridike, me rastin e lënies në fuqi të Vendimit të datës 27.11.2019 për shqiptimin e masës disiplinore "Ndales në pagë 30% për 3 muaj nga paga bruto", nga Komisioni i Brendshëm Disiplinor, pasi që Prokuroria Themelore - Departamenti i Krimeve të Rënda në Prishtinë me Aktvendimin me numër PP.Lnr.3/18 të datës 26.12.2018, me të cilin i ka pushuar hetimet ndaj tij, për shkak se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm që është kryer veprë penale "keqperdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar e sanksionuar sipas nenit 422 par.1 të KPRK-së".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet e ankuesit ka konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, gjegjësisht Komisioni i Brendshëm Disiplinor, pasi që me datë 15.11.2019 ka pranuar Aktvendimin Nr.PP.Lnr.3/18 të datës 26.12.2018 nga Prokuroria Themelore-Departamenti i Krimeve të Rënda në Prishtinë, nuk ka vepruar në pajtim me nenin 63 paragrafin 5 nën paragrafin 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me rastin e inicimit të procedurës disiplinore

tek Komisioni i Brendshëm Disiplinor lidhur me lëndën me numër 092-PK-2018(IPK-DH-02-18-VP), por ka vepruar në kundërshtim me nenin 63 paragrafin 5 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *“Nëse nëpunësi civil i akuzuar për kryerje të veprës penale shpallet i pafajshëm: 5.1. ai/ajo do të kthehet në vendin e punës dhe në dosje nuk do të përfshihet asnjë përmendje e procedurës penale dhe/ose pezullimit parandalues; 5.2. asnjë masë disiplinore nuk do të merret kundër nëpunësit civil pas shpalljes i/e pafajshëm ose përjashtimit nga një procedurë penale”*, sepse bazuar në provat e lëndës është vërtetuar se Prokuroria Themelore-Departamenti i Krimeve të Rënda në Prishtinë, me datë 26.12.2018 ka nxjerrë Aktvendimin Nr.PP.Lnr.3/18, për pushimin e hetimeve ndaj ankuesit për shkak se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm/bazuar që është kryer vepra penale *“keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar e sanksionuar sipas nenit 422 par.1 të KPRK-së”*, në rastin konkret ankuesi është përjashtuar nga ndjekja penale, lidhur me rastin 092-PK-2018-IPK-DH-02-18-VP, për të cilin rastë është ushtruar kallëzim penal nga Inspektoriat Policor i Kosovës, me datë 18.01.2018, dhe janë vërtetuar rrethanat mbi bazën e tejkalimit të kontratës kornizë për shërbime me kompanin “NTL Flomed”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni i Brendshëm Disiplinor i Policisë së Kosovës, me datë 03.12.2019 ka nxjerrë Vendimin me nr.protokolli 1923/2019, me të cilin ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore *“Ndales në pagë 30% për 3 muaj nga paga bruto”*, me arsyetimin se më datë 12.06.2018 Komisioni i Brendshëm Disiplinor, ka mbajtur seancë dëgjimore lidhur me rastin 092-PK-2018-IPK-DH-02-18-VP dhe ka vendosur të **pezulloj procedurën** deri në vendimin nga organi kompetent gjyqësor, sipas vendimit të datës 14.06.2018, më pas thekson se me datë 15.11.2019 ka pranuar Aktvendimin Nr.PP.Lnr.3/18 të Prokurorisë Themelore-Departamenti i Krimeve të Rënda në Prishtinë, dhe ka shqyrtuar procedurën disiplinore dhe ka nxjerrë vendimin e datës 03.12.2019 duke vepruar në kundërshtim me dispozitën ligjore të lartë cekur, për të cilën procedurë Komisioni i Brendshëm Disiplinor në Policinë e Kosovës, ka shqiptuar masën disiplinore duke mos arsyetuar gjendjen faktike dhe bazën juridike, sepse rasti i inicuar me numër 092-PK-2018-IPK-DH-02-18-VP edhe pse është pezulluar me Vendimin e datës 14.06.2018 të Komisionit të brendshëm disiplinor, mbi këtë bazë, në provat e lëndës nuk është dëshmuar me asnjë provë se procedura disiplinore e pezulluar është aktivizuar me ndonjë akt administrativ për vazhdimin e shqyrtimit disiplinor nga Komisioni i Brendshëm Disiplinor, pas pranimit të Aktvendimit të datës 12.06.2018, por i njëjti në vendim ka theksuar se është bazuar në raportin e datës 28.05.2018 të Drejtoris për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluares të datës 28.05.2018, ku është rekomanduar masa e rëndë disiplinore *“ndërprerje e marrëdhënies së punës”*, për ankuesin.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni i Brendshëm Disiplinor i Policisë së Kosovës, me datë 03.12.2019 ka nxjerrë Vendimin me nr.protokolli 1923/2019, me të cilin ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore *“Ndales në pagë 30% për 3 muaj nga paga bruto”*, i cili vendim është nxjerrë në kundërshtim me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;1.5. është në kundërshtim me ligjin material”*, dhe neni 53 paragrafi 1 i këtij ligji, përcakton se *“Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi*

publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ndaj ankuesit kanë pushuar hetimet në bazë të Aktvendimit Nr.PP.I.nr.3/18 të datës 26.12.2018 të Prokurorisë Themelore-Departamentit të Krimeve të Rënda në Prishtinë, për shkak se nuk ekziston dyshimi i bazuar që është kryer vepra penale “keqperdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar e sanksionuar sipas nenit 422 par.1 të KPRK-së”, me të cilin nëpunësi civil është liruar nga përgjegjësia, organi i punësimit gjegjësisht Policia e Kosovës, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, ka qenë i obliguar që ndaj ankuesit të mos zhvilloj procedurë disiplinore tek Komisioni i Brendshëm Disiplinor, lidhur me lëndën me numër 092-PK-2018(IPK-DH-02-18-VP), sepse ankuesi është liruar nga përgjegjësia me Aktvendimin Nr.PP.I.nr.3/18 të Prokurorisë Themelore-Departamentit të Krimeve të Rënda, lidhur me faktet dhe provat e dëshmuar në këtë Aktvendim, ankuesi nuk ka shkaktuar dëm institucionit sepse nuk është konstatuar përgjegjësia për tu sanksionuar, me ndonjë masë disiplinore, me rastin e tejkalimit të afatit të kontratës së kompanisë “NTP Flomed”, e lidhur me Policinë e Kosovës me datë 28.07.2015 me nr.214/15/034/211, i cili ka qenë i caktuar menaxher i kontratës kornizë, nga e cila përgjegjësi Prokuroria Themelore-Departamentit të Krimeve të Rënda, ka dhënë sqarime specifike, citoj: “... duke u bazuar në veprimet e marra nuk ka hasur në asnjë provë inkriminuese në bazë të cilës do të argumentonte dyshimin e bazuar se i dyshuari të ketë kryer veprë penale në kohë dhe vendin e përshkruar në aktvendimin mbi fillimin e hetimeve ndaj të njejtit apo ndonjë veprë tjetër penale e cila do të ndiqej sipas detyrës zyrtare...”. Ndërsa saj përket çështjes së tejkalimit të sasis së shërbimeve të kryera apo të pagesave që duhej të kryhen për ato shërbime, është theksuar se, citoj: “...në veprimet e të dyshuarit nuk është gjetur se janë plotësuar elementet e kësaj vepre penale për të cilën është dyshuar se e ka kryer ngase i njejtë këto veprime i kishte ndërmarrë për shkak se ishte gjendur në situatë urgjente për ta përgaditur stadiumin në mënyrë të përshtatshme në mënyrë që loja në fjalë me karakter ndërkombëtarë dhe me rëndësi shumë të madhe për Kosovën të realizohet pa ndonjë incident që ka mund të shkaktojë nga gjendja jo e përshtatshme që gjendej ky stadium sikurse është theksuar edhe në raportin e vlerësimit ...”, si dhe është vërtetuar me dëshmin e dëshmitarit z. pronar i kompanisë “NTP Flomed”, i cili kishte theksuar se ankuesin e kishte njoftuar përmes telefonit për tejkalim të shërbimeve sipas kontratës korniz, dhe i njejtë kishet ndërmarrë veprimet të menjëhershme duke njoftuar Policinë e Kosovës dhe kishte ndërprerë punimet në Regjionin e Prizrenit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 03/02-464/19 të datës 27.12.2019 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit duke lënë në fuqi Vendimin e Brendshëm Disiplinor, ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit N.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejte gjendjen faktike dhe juridike.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari të Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.456/2021, datë 28.06.2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Vendimi i dërgohet:

- Ankesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

